

L I G J
Nr.8558, datë 22.12.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8474, DATË 14.4.1999 "PËR MIRATIMIN E
NOMENKLATURËS DHE TË TARIFËS DOGANORE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8474, datë 14.4.1999 "Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në krerët dhe nënkrerët e tabelës nr.1 tarifa doganore prej 20 për qind ndryshohet dhe zëvendësohet me tarifën doganore prej 18 për qind.

Neni 2

Në seksionin V, në kapitullin 27 me titull "Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre; substancat bituminoze, dyllet minerale", tarifa doganore e kodeve nr.2710 0066, 2710 0067 dhe 2710 0068 ndryshohet nga 20 për qind në 10 për qind.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2000.

**Shpallur me dekretin nr.2513, datë 31.12.1999, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**